



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111-27806/2015
Kaçanik, 25.08.2015

Në bazë të nenit 5 pika(c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit 05/2015 për arsimin profesional, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në shkollën e mesme të lartë profesionale të Komunës së Kaçanikut për vitin shkollor 2015/2016.

1. Shkolla e mesme profesionale : "Feriz guri dhe vëllezërit Çaka":

Tre mësimdhënës të lëndës, Matematikë.

Një mësimdhënës, i Makinerisë -Komunikacion Rrugor, me 11 orë.

Një mësimdhënës, i Makinerisë, me 10 orë.

2. Shkolla fillore e mesme e ulët „Naim Frashëri” në Kotlinë:

Një Punëtorë Teknik.

Kushtet e Konkursit:

1. Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it .Nr.06/2015, Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe udhëzimit administrativ nr.05/2015 Normativi për mësimdhënësit e Arsimit Profesional . Kandidatët të cilët aplikojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta: diploma e fakultetit përkatës, certifikata e lindjes, kopjen e letërnjoftimit, dëshmi mbi përvojën e punës në arsim, dhe certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHT .

Të drejtë aplikimi në konkurs kanë kandidatët e degës përkatëse.

2. Ndërsa, për vendin e punës, Punëtor Teknik, kandidatët duhet ti paraqesin këto dokumente : Diplomën e përgatitjes shkollore (Shkolla e mesme e dëshiruar), certifikatën e lindjes, kopjen e letërnjoftimit, certifikata të trajnimeve .

Sqarime shtesë :

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen , ndërsa origjinalin duhet ta sjellin në ditën e intervistimit .

Nëse kandidati aplikon në më shumë se një pozitë/institucion , ftohet në intervistë vetëm në shkollën /institucionin me prioritet të parë.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimore-Zyra e Pranimit, kati përdhes.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.



Drejtori i drejtorisë;
Enver Kamishi